



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. PPP/ Prot.
4

Tiranë, më 26. 4. 2021

VENDIM

Nr. 14, datë 26 . 04 . 2021

“Për miratimin e riorganizimit të programit të studimeve të doktoratës në “Shkenca Humane, Albanologjike dhe Gjeografike”, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të UT-së, për vitin akademik 2021-2022”


Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 2/b; neni 35, pika 1; neni 38, pika 1/dh; neni 77 dhe neni 91, pika 3; VKM nr. 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar; Udhëzimin e MASR, nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, Kreu IV, gërma “E”; Udhëzimin e MASR, nr. 10, datë 30.03.2020, “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, i ndryshuar, Kreu I, pika 2, Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, gërmat “f” dhe “j”, si dhe në propozimin e përcjellë nga Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë me shkresat nr. 439 Prot., dhe nr. 439/1 Prot., datë 19.04.2021, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 26.04.2021;

VENDOSI:

1. Të miratojë riorganizimin e programit të studimeve të doktoratës në “Shkenca Humane, Albanologjike dhe Gjeografike” (në fushën e shkencave humane sipas manualit të FRASCAT-it), në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës, sipas nënfushave të mëposhtme:
 - “Histori”
 - “Gjeografi”
 - “Marrëdhënie Ndërkombëtare”
2. Të miratojë formën e diplomës, për programin e ciklit të tretë të studimeve të doktoratës, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të UT-së.
3. Dokumentacioni përkatës t’i përcillet për miratim Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

4. Pas miratimit të MASR-së, sipas pikës 3 të këtij vendimi, dokumentacioni përkatës të përcillet edhe në Qendrën e Shërbimeve Arsimore për regjistrimin e formës së diplomës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI



Prof. Dr. Artan Hoxha